



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ✓

Nr. 1215/112 Prot.

Tiranë, më 13 / 05 / 2026

**Lënda:** Përcillen Amendamentet (*komentet*) lidhur me ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit dhe propozohen disa ndryshime në Rregulloren e Kuvendit

**Drejtuar:** **Z. Niko PELESHI**  
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

**Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste**  
**Grupit Parlamentar të Partisë së Lirisë**  
**Grupit Parlamentar “Aleanca për Ndryshim”**

Të nderuar,

Në Kuvendin e Shqipërisë janë depozituar dy iniciativa të njëanshme për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit, nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste dhe nga Kryetari i Kuvendit z. Niko Peleshi.

Në parim, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është kundër ndryshimeve të njëanshme në Rregulloren e Kuvendit, e cila është akti që garanton bashkëjetesën demokratike ndërmjet palëve politike. Çdo ndryshim në Rregulloren e Kuvendit duhet të jetë produkt i një procesi diskutimesh gjithëpërfshirëse dhe të miratuara në mënyrë konsensuale, siç ka qenë tradita parlamentare nga viti 2004 e në vijim. Rikujtojmë, që në vitin 2013, ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit ishin një prej tre kushteve që kërkoheshin, me qëllim marrjen e statusit të vendit kandidat në Bashkimit Evropian, dhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike edhe pse i kishte numrat nuk i miratoi këto ndryshime, pa pasur edhe konsensusin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është kundër çdo lloj ndryshimi që synon të kufizojë hapësirat dhe të drejtat e opozitës në Parlament. Në fakt, një pjesë e ndryshimeve të propozuara synojnë ekzaktësisht kufizimin e mëtejshëm të këtyre të drejtave, duke i shndërruar nga një kufizim faktik në një kufizim juridik. Kështu, propozimet për reduktimin e kohës së diskutimeve nga 10 në 5 minuta, shqyrtimi me procedurë të përshpejtuar i projektligjeve që synojnë përfrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian apo heqja e raportimit të drejtuesve të organeve kushtetuese dhe institucioneve të krijuara me ligj në komisionet e përhershme parlamentare dhe në seancën plenare, janë përpjekje të qarta për të minuar funksionimin demokratik të Parlamentit, për të asgjësuar rolin e opozitës në Parlament dhe për ta shndërruar Parlamentin në një institucion monopartiak, sic në fakt janë aktualisht shumica e institucioneve në Shqipëri. Pushteti

vetërregullues i Kuvendit nuk duhet të bëhet premisë që të drejtat e deputetëve të cenohen në atë masë që do të çonte drejtpërdrejt në cenimin e parimit të demokracisë përfaqësuese.

Mirëpo, gjatë diskutimeve në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, në mbledhjen e datës 11 Maj 2026, të gjithë anëtarët e tij, njohën faktin se sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, *“në kushtet kur shumica parlamentare e ka numrin e nevojshëm të deputetëve për miratimin e aktit, ajo duhet të dëshmojë vullnet për një kujdes të shtuar dhe frymë bashkëpunimi për të siguruar që pakica parlamentare të luajë një rol aktiv në procesin e shqyrtimit të projektaktit, duke ushtruar të drejtën e debatit për përmbajtjen dhe procedurën e tij, si dhe duke gëzuar mundësinë e propozimit të amendamenteve kur kjo shihet e arsyeshme, duke synuar që ndryshimet mundësisht të bëhen me vullnet të përbashkët dhe konsensual.”*<sup>1</sup>.

Në përmbushje të këtij standardi kushtetues, opozita po përmbush rolin e saj, duke shpresuar se mazhoranca gjithashtu do të luaj një rol konstruktiv, me qëllimin final të hartimit të ndryshimeve konsensuale në Rregulloren e Kuvendit.

Për këtë qëllim, bashkëlidhur do të gjeni:


- 1) Aneksin 1 – Komente mbi ndryshimet e propozuara nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, sëbashku me Amendamentet e propozuara nga ana jonë në lidhje me këto ndryshime.
- 2) Aneksin 2 - Komente mbi ndryshimet e propozuara nga Kryetari i Kuvendit z. Niko Peleshi, sëbashku me Amendamentet e propozuara nga ana jonë në lidhje me këto ndryshime.

Gjithashtu, në mbështetje të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, bashkëlidhur do të gjeni disa propozime për ndryshimin e Rregullores së Kuvendit, të propozuara nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike. Ne mbetemi të angazhuar për të luajtur rolin tonë konstruktiv në këtë proces të rëndësishëm parlamentar, duke shpresuar që mazhoranca do të heq dorë nga imponimi i rregullave të njëanshme dhe ndryshimeve pa konsensus në Rregulloren e Kuvendit.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

## GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

GAZMENT BARDHI



KRYETAR

<sup>1</sup> Shiko vendimin nr. 18/2026 të Gjykatës Kushtetuese



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*PROJEKT*

**VENDIM**

Nr. \_\_\_\_/2026

**“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 116, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar**

Në mbështetje të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

### **KUVENDI I SHQIPËRISË**

#### **VENDOSI:**

Në vendimin e Kuvendit nr. 116, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

#### **Neni 1**

Në nenin 7, pika 3/1, pas fjalisë së parë shtohet fjalia e dytë me përmbajtje si më poshtë:

Kryesimi i grupeve të miqësisë, përcaktohet nga Kryetari i Kuvendit në këshillim me kryetarët e grupeve parlamentare, duke mbajtur parasysh përfaqësimin politik sipas përpjesëtimit që zënë në Kuvend.

#### **Neni 2**

Në nenin 10, pika 3, fjalia e tretë ndryshohet si më poshtë:

Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën përbëhet nga një sekretar dhe pesë anëtarë, në raporte të barabarta ndërmjet shumicës dhe pakicës parlamentare.

#### **Neni 3**

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

1. Grupeve parlamentare u sigurohen mjediset e punës dhe pajisjet e nevojshme për funksionimin e tyre, në dispozicion të deputetëve dhe të stafit mbështetës.
2. Çdo grupi parlamentar i vihet në dispozicion staf politik mbështetës. Grupi parlamentar më i madh i shumicës dhe grupi parlamentar më i madh i pakicës ka në dispozicion një numër stafi politik mbështetës, të barabartë, që nuk mund të jetë më i vogël se numri i përgjithshëm i komisioneve të përhershme, dhe që përcaktohet me vendim të Byrosë së Kuvendit. Grupet e tjera parlamentare kanë në dispozicion një numër stafi politik mbështetës, në proporcion me madhësinë e grupit parlamentar, sipas numrit dhe pozicionit të përcaktuar me vendim të Byrosë së Kuvendit.

#### **Neni 4**

Në nenin 48, pika 1, pas fjalisë së tretë, shtohet fjalia e katërt me përmbajtje si më poshtë:

Ky rregull zbatohet për të gjitha aktet që shqyrtohen dhe miratohen nga Kuvendi.

#### **Neni 5**

Në nenin 49, bëhen këto ndryshime:

- a) Pas fjalisë së dytë, të pikës 1, shtohet fjalia e tretë me përmbajtje si më poshtë:

“Në rast se pranohet kërkesa për ndërprerjen e seancës plenare ose të diskutimeve, zbatohet rregulli i parashikuar nga neni 66, pika 3, e kësaj Rregulloreje.”.

- b) Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me përmbajtje si më poshtë:

“Në rast të zgjatjes së seancës plenare përtej orës 22:00, me kërkesë të kryetarit të një grupi parlamentar, seanca plenare ndërpritet dhe rifillon ditën pasardhëse në ora 10:00.”.

#### **Neni 6**

Neni 65/3, pika 4, ndryshohet si më poshtë:

4. Me paraqitjen e ankimit, urdhri i drejtuesit të seancës plenare/komisionit dhe/ose vendimi i Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën pezullohet deri në dhënien e vendimit nga Byroja e Kuvendit.

#### **Neni 7**

Pas nenit 99, shtohet nenin 99/1, me përmbajtje si më poshtë:

Neni 99/1

E drejta për informim

1. Deputeti ka të drejtë të kërkojë informacione dhe shpjegime për cdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrës së tij nga cdo institucion i pushtetit qendror dhe vendor.
2. Titullarët e institucioneve janë të detyruar t'i përgjigjen deputetit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.
3. Në rast shkelje të pikës 2, të këtij neni, me kërkesë të një kryetari të grupi parlamentar, kryetari i Kuvendit i kërkon titullarit të institucionit të kthejë përgjigje brenda 5 ditëve. Nëse nuk respektohet ky afat, kryetari i Kuvendit i drejtohet organit epror, duke kërkuar marrjen e masave për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar dhe nxjerrjen e përgjegjësive administrative për refuzimin e përmbushjes së detyrimit sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni.

**Neni 8**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2026

**KRYETARI**

**NIKO PELESHI**

**RELACION**  
**MBI PROPOZIMET E GRUPIT PARLAMENTAR TË PARTISË DEMOKRATIKE**  
**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

Në nenin 7, pika 3/1, është propozuar shtimi i një fjalie, me qëllim që kryesimi i grupeve të miqësisë të respektojë përbërjen politike të Kuvendit, duke qenë se aktualisht shumica absolute e grupeve të miqësisë janë caktuar të drejtohen nga deputetët, anëtarë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, cka në fakt nuk përputhet me raportet ndërmjet shumicës dhe pakicës parlamentare në Kuvend. Në këto kushte, me qëllim shmangien e diskrecionit arbitrar, parashikohet që kryesimi i grupeve parlamentare bëhet me mirëkuptim ndërmjet kryetarit të Kuvendit dhe kryetarëve të grupeve parlamentare, duke respektuar përfaqësimin politik të palëve në Kuvend.

Në nenin 10, pika 3, është propozuar ndryshimi i fjalisë së tretë që lidhet me përbërjen e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën. Kjo pasi, për çështjet që trajton ky Sekretariat duhet të ketë përpjekje të sinqerta ndërmjet palëve për të gjetur konsensus, përfshirë edhe sanksionimin e sjelljeve që shkelin rregullat disiplinore. Etika dhe rregulli në veprimtarinë e Kuvendit është përgjegjësi e përbashkët dhe si e tillë duhet të ushtrohet në mënyrë të përbashkët. Në të kundërt, kjo strukturë, ashtu si edhe masat disiplinore mund të përdoren si një instrument politik në duart e mazhorancës për të abuzuar me pozitën e saj dominuese, cka është e papranueshme referuar vendimeve nr. 48/2024 dhe nr. 18/2026 të Gjykatës Kushtetuese, jurisprudencës së sistemit gjyqësor shqiptar, si dhe vendimit *Karacsony kundër Hungarisë* të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se: “*Nëse një deputet, për arsye të ndryshme, ndalohet ose pengohet të ushtrojë funksionin e tij si pjesë e parlamentit, atëherë cenohet parimi i përfaqësimit, si dhe raporti shumicë/pakicë i vendosur nga vullneti i zgjedhësve dhe që duhet të gjejë patjetër pasqyrim në parlament gjatë gjithë legjislaturës*”.

Në nenin 17 është propozuar ndryshimi i kësaj dispozite, duke përcaktuar detyrimin e Kuvendit për të vënë në dispozicion të deputetëve dhe të stafit mbështetës mjedise pune dhe pajisje të nevojshme për funksionimin e tyre, pasur parasysh faktin që aktualisht qoftë deputetët, ashtu edhe stafet mbështetëse të grupeve parlamentare nuk kanë mjedise dhe pajisje për të ushtruar funksionet e tyre. Nga ana tjetër, është propozuar që numri i këshilltarëve të dy grupeve më të mëdha parlamentare të jenë të barabarta me numrin e komisioneve të përhershme, si dhe grupet e tjera parlamentare të kenë staf mbështetës në proporcion me madhësinë e tyre, duke reflektuar kështu edhe rritjen e numrit të komisioneve të përhershme parlamentare.

Në nenin 48, pika 1, është propozuar shtimi i një fjalie, në përputhje edhe me konkluzionet e vendimit nr. 18/2026 të Gjykatës Kushtetuese, që për çdo akt që shqyrtohet dhe miratohet nga Kuvendi, deputetët kanë të drejtë të diskutojnë sipas rregullave të përgjithshme të parashikuara nga nenet 46 dhe 48 të Rregullores së Kuvendit. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se: “*Në këtë kuptim, kufizimi i së drejtës së fjalës ose heqja e saj deputetëve të pakicës parlamentare nga Kryetari i Kuvendit, që ka sjellë pamundësinë e ushtrimit në një kohë të arsyeshme të të drejtave të tyre kushtetuese, vlerësohet edhe se është në tejkalim të kompetencave të tij funksionale dhe bie ndesh me nenet 70, pika 1 dhe 75, pika 2, të Kushtetutës. Këto parashikime kushtetuese, të para të lidhura edhe me parashikimet e Rregullores dhe të ligjit nr. 8550/1999, nuk vendosin kufizime*

*substanciale ose përjashtime kategorike të së drejtës së fjalës së deputetit. Përkundrazi, Rregullorja në nenet 46 dhe 48 të saj parashikon të drejtën e deputetëve për të diskutuar pa vendosur kufizime që lidhen me llojin e veprimtarisë ose të aktit që po shqyrtohet nga Kuvendi, ndërsa neni 4 i ligjit për statusin e deputetit sanksionon të drejtën e fjalës së deputetit në funksion të procesit legjislativ për të gjitha projektaktet e Kuvendit.”.*

Në nenin 49, pika 1, është propozuar shtimi i një fjalie, duke harmonizuar parashikimet e kësaj dispozite me ato të nenit 66, pika 3, duke eliminuar kështu praktikën antikushtetuese të ndërprerjes së seancës plenare apo të diskutimeve dhe kalimit në votim, cka përbën cënim të parimit të demokracisë përfaqësuese dhe lirisë së shprehjes, duke e shndërruar procedurën parlamentare në antikushtetuese referuar konkluzioneve të vendimit nr. 18/2026 të Gjykatës Kushtetuese. Po ashtu, është propozuar shtimi i pikës 1/1, me qëllim që seancat plenare të mos zgjasin përtej orës 22:00, në funksion të parimit të transparencës dhe informimit të qytetarëve. Vetë neni 79, pika 1 e Kushtetutës që përcakton se mbledhjet e Kuvendit bëhen të hapura ka për qëllim pikërisht realizimin në praktikë të parimeve të transparencës dhe informimit, ndërkohë që zgjatja e seancave përtej orës 22:00 çënon këto dy parime, për shkak se vështirësohet apo pamundësohet ndjekja plotësisht e seancave plenare nga qytetarët që deputetët përfaqësojnë.

Në nenin 65/3, është propozuar ndryshimi i pikës 4, me qëllim që ankimi ndaj urdhrave dhe vendimeve për marrjen e masave disiplinore të jetë një mjet efektiv për deputetët që janë subjekte të masave disiplinore, duke respektuar kështu edhe të drejtën e tyre për një proces të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, ky parashikim është në përputhje me nenin 133 të Kodit të Procedurave Administrative (ligj i miratuar me shumicë të cilësuar), që përcakton pezullimin e aktit në rast të ushtrimit të ankimit administrativ.

Pas nenit 99, në kreun ku parashikohet mjetet e kontrollit parlamentar, është propozuar miratimi i një dispozite të re, e cila synon të garantojë zbatimin në praktikë të të drejtës për informim, të sanksionuar në nenin 8, të Ligjit nr. 8550/1999 “Statusi i Deputetit”. Vecanërisht kjo dispozitë synon që në rastet kur deputeti i çënohet apo mohohet e drejta për informim, të parashikohet një procedurë konkrete nëpërmjet bashkëpunimit të kryetarit të grupit parlamentar me kryetarin e Kuvendit për realizimin efektiv të kësaj të drejte.

## GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

GAZMENT BARDHI



---

KRYETAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

ANEKSI NR. 1

**KOMENTE DHE AMENDAMENTE MBI PROPOZIMIN E GRUPIT PARLAMENTAR TË PS  
PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

PROPOZIMI	KOMENTE	RIFORMULIM
<p>Pas nenit a/7, shtohet neni a/8 me përmbajtje si më poshtë:</p> <p><b>Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve që synojnë përfaqësimin</b></p> <p>Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përfshin menjëherë në programin dhe kalendarin e tij të punimeve dhe shqyrton me procedurë të përshpejtuar, projektligjet që synojnë përfaqësimin e legjislativitetit, marrëveshjet që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe/ose detyrimeve që dalin nga procesi i negociatave të anëtarësimit, me përjashtim të ligjeve të parashikuara në nenin 81, pika 2, të Kushtetutës.</p>	<p>Shqyrtimi me procedurë të përshpejtuar i projektligjeve që lidhen me përfaqësimin e legjislativitetit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, kufizon hapësirën e debatit parlamentar, e në këtë kuptim vlerësojmë se çënon parimin e demokracisë përfaqësues dhe lirisë së shprehjes, sipas interpretimeve të Gjykatës Kushtetuese në vendimet e saj nr. 48/2024 dhe nr. 18/2026, pasi për shkak të afateve të shkurtra të shqyrtimit të këtyre projektligjeve, deputetët do të kenë më pak kohë në dispozicion për të diskutuar, për të propozuar ndryshime, për të bërë pyetje, për votimin e informuar, si dhe për të bërë transparencë për qytetarët lidhur me nismat e</p>	<p>Të hiqet.</p> <p>Të jetë sipas formulimeve dhe komenteve në draftin e propozuar nga Kryetari i Kuvendit.</p>

	<p>propozuara. Nga ana tjetër, ky propozim është në kundërshtim me frymën dhe gërmën e nenit 83, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 28, pika 1, të Rregullores së Kuvendit që imponojnë ndjekjen e një procedure të detajuar për këtë lloj shqyrtimi, e cila në vetvete është përjashtim dhe nuk mund të shndërrohet në një rregull të përgjithshëm. Prandaj, lidhur me këtë dispozitë qëndrimi ynë është kundër, duke pasur parasysh se raste specifike të shqyrtimit të projektligjeve që synojnë përafrimin e legjislacionit shqiptar me Bashkimin Evropian mund reflektohen në nenin 28 të Rregullores së Kuvendit, sipas propozimit të Kryetarit të Kuvendit.</p>	
<p><b>Neni 2</b></p> <p>Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:</p> <p>1. Pika 1 ndryshon si më poshtë:</p> <p>“1. Kuvendi miraton në seancë plenare komisioneve të përhershme me emërtesat dhe fushat e përgjegjësisë si më poshtë:</p>	<p>Ky version i propozuar i strukturës së komisioneve të përhershme parlamentare është i njëjtë me atë të miratuar me vendimin nr. 57/2025 të Kuvendit, i shfuqizuar me vendimin nr. 18/2026 të Gjykatës Kushtetuese, për shkak të cënimit të parimit të</p>	<p>Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:</p> <p>Pika 1 ndryshon si më poshtë:</p> <p>“1. Kuvendi miraton në seancë plenare ngritjen e 11 komisioneve të përhershme me emërtesat dhe fushat e përgjegjësisë si më poshtë:</p>

<p>- Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat. (Cështjet e politikave ekonomike me tregut të përbashkët evropian, Buxhetin e Shtetit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij, marrëdhëniet e punësimit, lirisë së lëvizjes së punëtorëve, financat publike, privatizimet dhe sistemin bankar.)</p> <p>- Komisioni për Cështjet Ligjore dhe Administratën Publike. (Kodet dhe ligjet duke garantuar zbatueshmërinë e tyre me standardin evropian; organizimin e pushtetit gjyqësor dhe raportimin e tij, administratën e pushtetit gjyqësor; administratën publike, institucionet e pavarura në sistemin e drejtësisë.)</p> <p>- Komisioni për Cështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes. (Cështjet e brendshme, të rendit, organizimit dhe sigurisë kombëtare e publike, organizimin e Forcave të Armatosura dhe bashkëpunimin bashkëpunimin ushtarak; cështjet e organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor, emergjencat civile nga fatkeqësitë, shërbimet sekrete.)</p> <p>- Komisioni për Edukimin, Shkencën dhe Sportet. (Cështjet në fushën e arsimit, kërkimit inovacionit dhe zhvillimit të sportit.)</p> <p>- Komisioni për Shëndetësinë dhe Mirëqënien Sociale. (Cështjet lidhur me politikat shëndetësore, sigurimet shoqërore, familjen, gruan dhe cështjet për mirëqënien sociale.)</p> <p>- Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastrukturrën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm. (Cështjet në fushën e energjisë, burimeve natyrore dhe biodiversitetit, infrastrukturrën, industrinë dhe</p>	<p>demokracisë përfaqësuese të lidhur me lirinë e shprehjes së deputetëve si pasojë e shkeljes së rregullave të thirrjes së mbledhjes së Kuvendit si dhe të procedurës së ndjekur për miratimin e aktit objekt shqyrtimi. Megjithatë, në koherencë edhe me qëndrimet që ka mbajtur Grupi Parlamentar i PD-së në fillim të kësaj legjislatore parlamentare, vlerësoj se kjo strukturë duhet kundërshtuar përsa i përket parashikimit sërish të Komisionit për Evropën dhe Punët e Jashtme, që është një shkrije e Komisionit për Punët e Jashtme dhe Komisionit për Cështjet Evropiane. Duke pasur parasysh fazën kritike në të cilën ndodhet integrimi evropian i vendit, faktin që vendet e rajonit ka një komision të posaçëm për cështjet evropiane apo ato të integritit evropian, si dhe me qëllim garantimin e gjithëpërfshirjes dhe një roli domethënës të opozitës në këtë proces, Grupi Parlamentar i PD-së duhet të kërkojë që të ketë një ndarje të Komisionit për Evropën dhe</p>	<p>- Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat. (Cështjet e politikave ekonomike me tregut të përbashkët evropian, Buxhetin e Shtetit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij, marrëdhëniet e punësimit, lirisë së lëvizjes së punëtorëve, financat publike, privatizimet dhe sistemin bankar.)</p> <p>- Komisioni për Cështjet Ligjore dhe Administratën Publike. (Kodet dhe ligjet duke garantuar përputhshmërinë dhe zbatueshmërinë e tyre me standardin evropian; organizimin e pushtetit gjyqësor dhe raportimin e tij, administratën e pushtetit gjyqësor; administratën publike, institucionet e pavarura në sistemin e drejtësisë.)</p> <p>- Komisioni për Cështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes. (Cështjet e brendshme, të rendit, organizimin e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare e publike, organizimin e Forcave të Armatosura dhe bashkëpunimin ushtarak; cështjet e organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor, emergjencat civile dhe mbrojtja nga fatkeqësitë, shërbimet sekrete.)</p> <p>- Komisioni për Edukimin, Shkencën dhe Sportet. (Cështjet në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, inovacionit dhe politikat e zhvillimit të sportit.)</p>
---	---	--

<p>telekomunikacionin, rregullimin e territorit, tregtinë dhe mbrojtjen e mjedisit dhe çështjet për zhvillimin e qëndrueshëm.)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik.</li> </ul> <p>(Çështjet në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, çështjet lidhur me veprimtarinë e mediave audiovizive dhe informimit dhe çështjet për garantimin e lirisë së shprehjes.)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural.</li> </ul> <p>(Çështjet e bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit, çështjet e zhvillimit rural, çështjet e kontrollit dhe garantimit të sigurisë ushqimore, monitorimin e zbatimit të politikave në fushën e bujqësisë dhe të sigurisë ushqimore.)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisioni për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën.</li> </ul> <p>(Çështjet e kulturës kombëtare dhe trashëgimisë kulturore, zhvillimit të kulturës, turizmit dhe diasporës dhe të pjesëmarrjes së saj në proceset politike dhe sociale në vend.)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisioni për Evropën dhe Punët e Jashtme.</li> </ul> <p>(Çështjet e integritetit evropian, përafrimi i legjislacionit me legjislacionin e Bashkimit Evropian; mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, mbikëqyrja e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Shqipërinë; monitorimi i negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian, politikat e jashtme, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërkombëtare, si dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.)</p>	<p>Punët e Komisionin Evropian dhe Punët e parit për të opozitës parlamentare.</p> <p>Jashtme, në Çështjet Komisionin për Evropiane dhe Komisionin për Punët e Jashtme, ku drejtimi i të parit duhet t'i lihet një përfaqësuesi të opozitës parlamentare.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisioni për Shëndetësinë dhe Mirëqënien Sociale. (Çështjet lidhur me politikat shëndetësore, sigurimet shoqërore, familjen, gruan dhe çështjet për mirëqënien sociale.)</li> <li>- Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastrukturrën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm. (Çështjet në fushën e energjisë, burimeve natyrore dhe biodiversitetit, infrastrukturrën, industrinë dhe telekomunikacionin, rregullimin e territorit, tregtinë dhe mbrojtjen e mjedisit dhe çështjet për zhvillimin e qëndrueshëm.)</li> <li>- Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik. (Çështjet në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, çështjet lidhur me veprimtarinë e mediave audiovizive dhe informimit dhe çështjet për garantimin e lirisë së shprehjes.)</li> <li>- Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural. (Çështjet e bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit, çështjet e zhvillimit rural, çështjet e kontrollit dhe garantimit të sigurisë ushqimore, monitorimin e zbatimit të politikave në fushën e bujqësisë dhe të sigurisë ushqimore.)</li> <li>- Komisioni për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën. (Çështjet e kulturës kombëtare dhe trashëgimisë kulturore, zhvillimin e</li> </ul>
--	---	---

- Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale.  
(Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të strategjive, të rezolutave, vendimeve dhe planeve të veprimit të Kuvendit; shqyrtimi dhe ndjekja e nismave të qytetarëve dhe peticioneve; realizimi dhe koordinimi, mbikëqyrja dhe kontrolli i zbatimit të ligjeve nga ekzekutivi, institucionet dhe agjencitë e pavarura prej tij, përmes koordinimit të procesit parlamentar për kontrollin postlegjislativ (PLS); koordinimi i dialogut dhe bashkëpunimit ndërinstytucional.)

Pas pikës 3 shtohet pika me përmbajtje si më poshtë:

“4. Kudo në Rregulloren e Kuvendit emërtesat e komisioneve të përhershme zëvendësohen sipas emërtesës së komisioneve të përhershme në nenin 19, pika 1, të këtij vendimi.”

turizmit të qëndrueshëm; politikat për ruajtjen e identitetit kulturor e gjuhësor të diasporës dhe të pjesëmarrjes së saj në proceset politike dhe sociale në vend.)

- Komisioni për Cëshjtjet Evropiane.  
(Cëshjtjet e integritetit evropian, përafrimi i legjislacionit me legjislacionin e Bashkimit Evropian; mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, mbikëqyrja e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Shqipërinë; monitorimi i negociatave të anëtarësimit me Bashkinin Evropian.)

- Komisioni për Punët e Jashtme.  
(Politikat e jashtme, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërkombëtare, si dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.)

- Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale.

(Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të strategjive, të rezolutave, vendimeve dhe planeve të veprimit të Kuvendit; shqyrtimi dhe ndjekja e nismave të qytetarëve dhe peticioneve; realizimi dhe koordinimi, mbikëqyrja dhe kontrolli i zbatimit të ligjeve nga ekzekutivi, institucionet dhe agjencitë e pavarura prej tij, përmes koordinimit të procesit parlamentar për kontrollin postlegjislativ (PLS); koordinimi i dialogut dhe bashkëpunimit ndërinstytucional.)

		<p>Pas pikës 3 shtohet pika me përmbajtje si më poshtë:</p> <p>“4. Kudo në Rregulloren e Kuvendit emërtesat e komisioneve të përhershme zëvendësohen sipas emërtesës së komisioneve të përhershme në nenin 19, pika 1, të këtij vendimi.”.</p> <p>Në nenin 20, pika 3 ndryshohet si më poshtë:</p> <p>Deputeti, anëtar i Komisionit për Cështjet Evropiane, mund të jetë anëtar edhe në një komision tjetër të përhershëm, kur kjo lind e nevojshme për respektimin e raporteve ndërmjet shumicës dhe pakicës parlamentare.</p>
<p><b>Neni 3</b></p> <p>Në nenin 20 pika 3 shfuqizohet.</p>	<p>Në eventualitetin e pranimit të kërkesës për rikrijimin e Komisionit për Cështjet Evropiane mund të lindë e nevojshme që anëtarëve të këtij komisioni t’iu lejohet anëtarësia në dy komisione.</p>	
<p><b>Neni 4</b></p> <p>Në nenin 28, pika 2, fjalia e fundit “Projektligji që synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian nuk shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar” shfuqizohet.</p>	<p>Dakord. Shfuqizimi i kësaj dispozite është në përputhje me nenin 83, pika 2, të Kushtetutës dhe nenin 28, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, sepse kur lind e nevojshme edhe projektligjet që synojnë përafrimin e legjislacionit me BE-në mund të shqyrtohen me procedurë të përshpejtuar, duke qenë kjo një përjashtim dhe jo rregull i përgjithshëm (shih edhe komentet më lart për nenin 1).</p>	<p>Nuk kemi.</p>

### Neni 5

Në nenin 47, pika 1/1, togfjalëshi “jo më shumë se 10 minuta”, zëvendësohet me togfjalëshin “jo më shumë se 5 minuta”.

Propozimi për kufizimin e kohës së diskutimit të një deputeti nga 10 në 5 minuta, injoron plotësisht konkluzionet e vendimeve nr. 48/2024 dhe nr. 18/2026 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimit Karacsony kundër Hungarisë, të cilët në mënyrë të përsëritur kanë theksuar se shumica parlamentare nuk mund të përdorë pozicionin e saj dominues për të cënuar të drejtat e deputetëve të opozitës, me theks të vecantë tek liria e shprehjes. Kjo e fundit, sipas jurisprudencës kushtetuese dhe konventore, gëzon një mbrojtje të posacme të sanksionuar nga Kushtetuta dhe Konventa, si pjesë e parimit të demokracisë përfaqësuese. Cdo ndërhyrje në lirinë e shprehjes, vecanërisht të deputetëve të opozitës duhet të jetë sa më e kufizuar dhe e justifikuar me arsye të vecanta. Kufizimi i kohës së diskutimeve synon të reduktojë hapësirën e deputetëve të opozitës në Parlament, duke vështirësuar ushtrimin e funksioneve të tyre, përfshirë përfaqësimin efektiv të

Të hiqet.

	<p>qytetarëve nëpërmjet diskutimeve, propozimeve, debatit, interpelancave e pyetjeve, mocioneve, deklaratave dhe votës. Në këtë kuptim, kjo nismë çënon parimin e demokracisë përfaqësuese dhe lirinë e shprehjes së deputetëve, në kundërshtim me nenin 1, pika 2, nenin 2, pikat 1 dhe 2, nenin 70, nenin 73, të Kushtetutës, që garantojnë statusin kushtetues të deputetit, ashtu si edhe me nenin 132 të Kushtetutës, që sanksionon forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, ky propozim duhet të hiqet.</p>	
<p><b>Neni 6</b></p> <p>Në nenin 48, pika 1, fjalët “jo më shumë se 10 minuta” zëvendësohet me fjalët “jo më shumë se 5 minuta”.</p>	<p>Shih komentin për nenin 5 më lart.</p>	<p>Të hiqet.</p>
<p><b>Neni 7</b></p> <p>Në nenin 102, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:</p> <p>1. Pika 4, ndryshon si më poshtë:</p> <p>“4. Komisioni përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale, në kuadër të funksionit të kontrollit parlamentar ndaj ministrive dhe institucioneve të tjera</p>	<p>Lidhur me pikën 4, vlerësojmë se procesi i kontrollit post-legjislativ nuk është vetëm detyrë e Komisionit përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale, por e të gjitha komisioneve të përherhme sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, në përputhje me nenin 18, pika 1,</p>	<p>Të hiqet.</p>

<p>publike, koordinon dhe ndjek realizimin e procesit të Kontrollit Post-Legjislativ të ligjeve të miratuara nga Kuvendi për sa i takon zbatimit dhe efektivitetit të tyre duke bashkëpunuar edhe me komisionet e tjera të përershme parlamentare brenda fushave përkatëse të tyre të përgjegjësisë.”.</p> <p>2. Pas pikës 4, shtohet pika 5, me përmbajtje si më poshtë:</p> <p>“5. Në kuadër të këtij procesi komisionet organizojnë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara.”</p>	<p>dhe nenin 102, pika 4, të Rregullores. Në këtë kuptim, kjo dispozitë zhbën një kompetencë të rëndësishme të komisioneve të përershme që është kontrolli post-legjislativ, duke e centralizuar këtë kompetencë në një komision të vetëm. Prandaj, sugjeroj që qëndrimi i Grupit të PD-së duhet të jetë kundër lidhur me këtë pikë, duke mbetur ashtu sic është aktualisht. Ndërsa, sa i përket pikës 5, vlerësoj se ajo ripërsërit parashikimin e bërë nga pika 2/1 e të njëjtit nen, e në këtë kuptim është e panevojshme/e padobishme. Në respekt edhe të rregullave të teknikës legjislative, përsëritja e të njëjtave parashikime në dy pika duhet hequr.</p>	
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b></p> <p>Neni 103 ndryshohet si më poshtë:</p> <p style="text-align: center;">“Neni 103</p> <p style="text-align: center;"><b>Raportimi në Kuvend</b></p> <p>1. Konferenca e Kryetarëve, me Kryetarit të Kuvendit, vendos në fillim të cdo viti për kalendarin e paraqitjes në Kuvend të raporteve të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.</p>	<p>Kjo dispozitë propozon që drejtuesit e institucioneve kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj nuk do të raportojnë më në komisionet e përershme parlamentare sipas fushave të përgjegjësisë dhe në seancë plenare, por vetëm në Komisionin “Xhafa”. Ajo që duhet shqetësuese dhe prek edhe parimin e demokracisë</p>	<p>Neni 103 ndryshohet si më poshtë:</p> <p style="text-align: center;">“Neni 103</p> <p style="text-align: center;"><b>Raportimi në Kuvend</b></p> <p>1. Konferenca e Kryetarëve, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, vendos në fillim të cdo viti për kalendarin e paraqitjes në Kuvend të raporteve të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.</p>

<p>2. Kalandari përmban organin kushtetues dhe atë të krijuar me ligj që do të raportojë, komisionet për shqyrtim dhe afatin ligjor për dorëzimin e raportit në Kuvend brenda afatit ligjor. Në rastet kur afati ligjor për depozitimin e raportit nuk është i përcaktuar në ligjin organik, Konferenca vendos afatin e depozitimit të tij.</p> <p>Kalandari i paraqitjes së raporteve njoftohet në të parë, publikohet dhe iu shpërndahet institucioneve.</p> <p>Në rast se nuk arrihet mirëkuptimi për kalendarin në konferencën e kryetarëve zbatohen përcaktimet e pikës 4, të nenit 27 të rregullores.</p>	<p>përfaqësuese, në kuptim të statusit kushtetues që ka deputeti për të ushtruar kontroll efektiv ndaj organeve kushtetuese dhe institucioneve të krijuara me ligj, është heqja e raportimit të drejtuesve të institucioneve në komisionet e përhershme dhe në seancë plenare, duke e kufizuar vetëm te Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale (i ashtuquajtur "Komisioni Xhafa"). Në fakt, nëpërmjet këtij propozimi deputetëve, që nuk janë anëtarë të këtij Komisioni, iu hiqet mundësia për të dëgjuar dhe pyetur në mënyrë të drejtpërdrejtë drejtuesit e organeve kushtetuese dhe institucioneve të krijuara me ligj, vecanërisht organeve të sistemit të drejtësisë. Me këta të fundit, dëgjesat në komisione dhe raportimi në seancë plenare ka pasur vëmendje publike të shtuar gjatë viteve të fundit, cka duket të ketë shqetësuar mazhorancën. Nga ana tjetër, përveç se iu heq mundësinë deputetëve në komisione për të</p>	<p>2. Kalandari përmban organin kushtetues dhe atë të krijuar me ligj që do të raportojë, komisionet për shqyrtim dhe afatin ligjor për dorëzimin e raportit në Kuvend brenda afatit ligjor. Në rastet kur afati ligjor për depozitimin e raportit nuk është i përcaktuar në ligjin organik, Konferenca vendos afatin e depozitimit të tij.</p> <p>Kalandari i paraqitjes së raporteve njoftohet në seancën dëgjimore më të parë, publikohet dhe iu shpërndahet institucioneve.</p> <p>Në rast se nuk arrihet mirëkuptimi për kalendarin në konferencën e kryetarëve zbatohen përcaktimet e pikës 4, të nenit 27 të rregullores.</p>
<p>3. Raporti i institucioneve, pas paraqitjes, futet menjëherë në programin e punës së Kuvendit dhe shqyrtohet nga komisioni përgjegjës i fushës.</p> <p>4. Komisioni përgjegjës i fushës organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe në përfundim të diskutimeve harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, ose përfshin rekomandime specifike në raportin e komisionit, të cilat ja përcjell komisionit përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale.</p>	<p>3. Raporti i institucioneve, pas paraqitjes, futet menjëherë në programin e punës së Kuvendit dhe shqyrtohet nga komisioni përgjegjës i fushës.</p> <p>4. Komisioni përgjegjës i fushës organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe në përfundim të diskutimeve harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, ose përfshin rekomandime specifike në raportin e komisionit, të cilat ja përcjell komisionit përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale.</p>	<p>3. Raporti i institucioneve, pas paraqitjes, futet menjëherë në programin e punës së Kuvendit dhe shqyrtohet nga komisioni përgjegjës i fushës.</p> <p>4. Komisioni përgjegjës i fushës organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe në përfundim të diskutimeve, pas marrjes së raportit nga komisioni përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale me rekomandime specifike që kanë dalë nga zbatimi i rezolutës së vitit paraardhës dhe nga monitorimi i veprimtarisë së tyre, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit dhe rekomandimet për vitin në vazhdim që ia paraqet seancës plenare.</p>
<p>5. Komisioni për mbikëqyrjen institucionale organizon seancë dëgjimore në të cilën drejtuesit e institucionit raportojnë për zbatimin e rezolutës së Kuvendit për vitin paraardhës dhe vlerësimin rreth projektrezolutës/rekomandimeve të paraqitura nga komisioni përgjegjës i fushës për vitin në vazhdim.</p> <p>6. Projektrezoluta e miratuar në mbledhjen e komisionit përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale i paraqitet seancës plenare, ndërsa raporti me rekomandime specifike, i përcillet me shkresë institucionit të pavarur përkatës.</p>	<p>5. Komisioni për mbikëqyrjen institucionale organizon seancë dëgjimore në të cilën drejtuesit e institucionit raportojnë për zbatimin e rezolutës së Kuvendit për vitin paraardhës dhe vlerësimin rreth projektrezolutës/rekomandimeve të paraqitura nga komisioni përgjegjës i fushës për vitin në vazhdim.</p> <p>6. Projektrezoluta e miratuar në mbledhjen e komisionit përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale i paraqitet seancës plenare, ndërsa raporti me rekomandime specifike, i përcillet me shkresë institucionit të pavarur përkatës.</p>	<p>5. Komisioni për mbikëqyrjen institucionale organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe në përfundim të diskutimeve, pas marrjes së raportit nga komisioni përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale me rekomandime specifike që kanë dalë nga zbatimi i rezolutës së vitit paraardhës dhe nga monitorimi i veprimtarisë së tyre, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit dhe rekomandimet për vitin në vazhdim që ia paraqet seancës plenare.</p>

<p>7. Komisionet, kur e cmojnë të nevojshme, në varësi të çështjeve të trajtuara në raportin vjetor ose që dalin gjatë shqyrtimit të tij, mund t'u kërkojnë informacione me shkrim institucioneve të tjera shtetërore ose institucioneve të pavarura, si dhe/ose t'i ftojnë në seancë dëgjimore organizatat e shoqërisë civile, që bashkëveprojnë dhe bashkëveprojnë dhe kontribuojnë në fushat që mbulon institucioni i pavarur.</p>	<p>dëgjuar raportimin dhe bërë pyetje, kjo kufizon edhe transparencën e punës së këtyre institucioneve, pasur parasysh se komisionet parlamentare nuk kanë të njëjtën vëmendje qytetare dhe pasqyrim mediatik. Pra, synohet që raportimet e këtyre institucioneve të kalojnë pa ndonjë vëmendje të vecantë, duke qenë tërësisht të centralizuara te Komisioni “Xhafa”, duke qenë kështu një përpjekje e qartë për kufizimin e të drejtës kushtetuese që kanë deputetët e opozitës, referuar edhe vendimin nr. 48/2024, për të ushtruar kontroll efektiv parlamentar ndaj organeve kushtetuese dhe institucioneve të krijuara me ligj. Në këtë kuptim, edhe ky ndryshim, ashtu si edhe ndryshimet e tjera synon qartazi të kufizojë të drejtat dhe hapësirën e deputetëve të opozitës në Parlament, pa ndonjë shkak apo arsye të vecantë, përveçse përdorimit abuziv të Rregullores së Kuvendit për të asgjësuar parlamentarizmin dhe për të shtypur pakicën</p>	<p>6. Komisioni, kur e cmon të nevojshme, në varësi të çështjeve të trajtuara në raportin vjetor ose që dalin gjatë shqyrtimit të tij, mund t'u kërkojnë informacione me shkrim institucioneve të tjera shtetërore ose institucioneve të pavarura, si dhe/ose t'i ftojnë në seancë dëgjimore organizatat e shoqërisë civile, që bashkëveprojnë dhe kontribuojnë në fushat që mbulon institucioni i pavarur.</p>
<p>8. Në projektrezolutë komisionet mund të reflektojnë rekomandime bazuar edhe në faktet e mbledhura nga organet e përmendura në pikën 7 të këtij neni.</p> <p>9. Në seancë plenare lexohet projektrezoluta për vlerësimin e punës së institucionit dhe më pas vijohet me diskutimet në lidhje me të.</p> <p>10. Një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë kanë të drejtë të kërkojnë me shkrim zhvillimin e debatit. Koha e debatit përcaktohet nga Konferenca e Kryetarëve dhe cdo deputet ka të drejtë të flasë jo më shumë se 5 minuta.</p>	<p>7. Komisioni në vlerësimin e raportit thërret në seancë dëgjimore titullarin e institucionit shtetëror ose të varësisë së tij për të dhënë informacione dhe shpjegime lidhur me çështjen e referuar nga institucioni i pavarur.</p> <p>8. Në projektrezolutë komisioni mund të reflektojë rekomandime bazuar edhe në faktet e mbledhura nga organet e përmendura në pikën 6 të këtij neni.</p>	<p>7. Komisioni në vlerësimin e raportit thërret në seancë dëgjimore titullarin e institucionit shtetëror ose të varësisë së tij për të dhënë informacione dhe shpjegime lidhur me çështjen e referuar nga institucioni i pavarur.</p>
<p>11. Mekanizimi i Monitorimit Periodik dhe Vjetor të Institucioneve, miratohet në seancë plenare. Komisioni përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale ndjek në vijimësi zbatimin e tij dhe kur cmohet e nevojshme informon Kuvendin për problematikat e dala.</p>	<p>9. Në seancë plenare titullari i institucionit paraqet raportin për jo më shumë se 20 minuta dhe më pas vazhdohet me pyetjet nga deputetët dhe përgjigjet nga titullari i institucionit, jo më shumë se 2 minuta secili. Në vijim lexohet projektrezoluta për vlerësimin e punës së institucionit dhe më pas vijohet me diskutimet në lidhje me të.</p> <p>10. Një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë kanë të drejtë të kërkojnë me shkrim zhvillimin e debatit. Koha e debatit është jo më shumë se 180 minuta.</p>	<p>9. Në seancë plenare titullari i institucionit paraqet raportin për jo më shumë se 20 minuta dhe më pas vazhdohet me pyetjet nga deputetët dhe përgjigjet nga titullari i institucionit, jo më shumë se 2 minuta secili. Në vijim lexohet projektrezoluta për vlerësimin e punës së institucionit dhe më pas vijohet me diskutimet në lidhje me të.</p> <p>10. Një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë kanë të drejtë të kërkojnë me shkrim zhvillimin e debatit. Koha e debatit është jo më shumë se 180 minuta.</p>

	<p>parlamentare. Prandaj, është e nevojshme që kjo dispozitë të rishikohet duke rikthyer seancat dëgjimore të drejtuesve të organeve kushtetuese dhe institucioneve të krijuara me ligj në komisionet e përhershme sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, si dhe raportimin e këtyre drejtuesve në seancë plenare. Kjo pasi, në Kushtetutë për organet kushtetuese si Avokati i Popullit (shih nenin 63/1), Këshilli i Lartë Gjyqësor (shih nenin 147/a), Prokurori i Përgjithshëm (shih nenin 148/b), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (shih nenin 149/a), Kontrolli i Lartë i Shtetit (shih nenin 164), përmendet shprehimisht raportimi në Kuvend, ndërsa kushtetutbërësi me Kuvend, sipas nenit 64 të Kushtetutës, ka nënkuptuar 140 deputetët e tij. Po ashtu, i njëjti parashikim gjendet edhe në ligjet organike për organet e tjera kushtetuese dhe institucionet e krijuara me ligj.</p>	<p>11. Një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë kanë të drejtë të kërkojnë të thirren në seancë plenare drejtuesit e institucioneve shtetërore për të dhënë shpjegime ose për të informuar Kuvendin për çështje të veprimitarisë së tyre. Kërkesa duhet të paraqitet me shkrim dhe Kuvendi vendos me votim të hapur dhe pa debat pasi dëgjon një folës pro dhe një kundër, jo më shumë se 3 minuta.</p> <p>12. Mekanizimi i Monitorimit Periodik dhe Vjetor të Institucioneve, miratohet në seancë plenare. Komisioni përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale ndjek në vijimësi zbatimin e tij dhe kur cmohet e nevojshme informon Kuvendin për problematikat e dala.</p>
Neni 9	Dakord.	-

<p>Në nenin 103/1 bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:</p> <p>1. Pika 6, ndryshohet si më poshtë:</p> <p>“6. Komisionet e përhershme parlamentare sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, mund të thërresin institucionet kushtetuese të pavarura dhe institucionet e krijuara me ligj, që raportojnë dhe informojnë Kuvendin, për të raportuar dhe për të dhënë informacione për çështje të integritetit evropian, duke u koordinuar paraprakisht me Komisionin për Çështjet Evropiane.”</p> <p>2. Në fund të pikës 7, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:</p> <p>“Para miratimit kalendari koordinohet me Komisionin përgjegjës për Çështjet Evropiane.”</p>		
<p><b>Neni 10</b></p> <p>Në nenin 103/3 bëhet ndryshimet e mëposhtme:</p> <p>1. Pika 3, ndryshohet si më poshtë:</p> <p>“3. Pas miratimit të planit nga Konferenca e Kryetarëve, Kryetari i Kuvendit ia përcjell planin vijtor me afatet kohore të përcaktuara ministrit përgjegjës për Marrëdhëniet me Kuvendit dhe ministrive përgjegjëse.”</p>	<p>Dakord.</p>	-

<p>2. Në fjalinë e parë të pikës 4, togfjalëshi “Komisionit për Evropën dhe Punët e Jashtme” ndryshohet me fjalën “Komisioneve”.</p>		
<p><b>Neni 11</b></p> <p>Në nenin 103/4 shtohet pika me përmbajtje si më poshtë:</p> <p>“4. Komisioni përgjegjës për Nismat qytetare, bashkëpunimin dhe mbikëqyrjen institucionale koordinon dhe mbikëqyr zbatimin e Strategjive dhe Planeve të Veprimit të miratuara nga Kuvendi. Në mbyllje të cdo sesi ai i paraqet Konferencës së Kryetarëve një raport informues mbi këtë proces. Kryetari i Kuvendit nëse e cmon të arsyeshme vendos paraqitjen e tij në seancë plenare.”</p>	<p>Dakord.</p>	-
<p><b>Neni 12</b></p> <p>Neni 104 ndryshohet si më poshtë:</p> <p>“Neni 104</p> <p><b>Nismat qytetare dhe petitionet</b></p> <p>1. Nismat qytetare dhe petitionet, të cilat i drejtohen Kuvendit, shqyrtohen nga Komisioni përgjegjës për Nismat Qytetare, bashkëpunimin dhe mbikëqyrjen institucionale.</p> <p>2. Pranohen për shqyrtim nismat dhe petitionet, të cilat janë bërë me shkrim, kanë emrin e dërguesit dhe nënshkrimet përkatëse, janë të kuptueshme dhe tregojnë qartë objektin e tyre.</p>	<p>Dakord.</p>	-

<p>3. Kërkesat me nisma qytetare dhe petitionet dërgohet nga Kryetari i Kuvendit në Komisionin përgjegjës për Nismat qytetare dhe petitionet. Kryetari i komisionit mund t'ia kthejë nismën ose petitionin dërguesve për rihartim ose t'u kërkojë atyre sqarime shtesë.</p> <p>4. Jo më vonë se 45 ditë nga data e marrjes së petitionit, Kryetari i komisionit e paraqet kërkesën me nismën ose petitionin në komision, duke propozuar njëkohësisht edhe mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes ligjore ose mospranimit e tyre. Në rast se komisioni e gjykon të arsyeshme për zgjidhjen e çështjes, mund të autorizojë kryetarin e komisionit, për të paraqitur një deklaratë në seancën plenare të Kuvendit. Hapat e ndërmarrë dhe zgjidhja e çështjes së ngritur i njoftohen dërguesve të nismës ose petitionit.</p> <p>5. Komisioni përgjegjës mund të vendosë dërgimin e nismës ose petitionit një komisioni tjetër parlamentar që ka lidhje me objektin e paraqitur në petition, Këshillit të Ministrave, institucioneve publike dhe Institucioneve të pavarura përgjegjëse për fushën për veprime të mëtejshme, me qëllim marrjen e informacioneve. Në përfundim, komisioni jep shpjegime me shkrim, propozon nismë legjislative ose merr vendim.</p> <p>6. Kuvendi miraton Mekanizmin e trajtimit dhe shqyrtimit të nismave qytetare dhe petitioneve.”</p>		
<p><b>Neni 13</b></p> <p>Në nenin 110, pika 4, fjalia e dytë, fjalët “në përputhje me nenin 48 të kësaj Rregulloreje”, zëvendësohen me fjalët “në mënyrë përpjesëtimore ndërmjet grupeve,</p>	<p>Në këtë pikë duhet shtuar togfjalëshi “...me përjashtim të rastit të parashikuar nga neni 47, pika 1/2 kësaj Rregulloreje.”, me qëllim respektimin e rregullit që</p>	<p>Shtohet togfjalëshi “...me përjashtim të rastit të parashikuar nga neni 47, pika 1/2 kësaj Rregulloreje.”</p>

<p>sipas përfaqësimit të tyre në Kuvend, por në cdo rast jo më shumë se 10 minuta për cdo deputet.”.</p>	<p>kryetari i grupit parlamentar më të madh të opozitës ose një përfaqësues i caktuar prej tij, për të njëjtën kohë sa ajo e Kryeministrit.</p>	<p>-</p>
<p>Neni 14</p> <p>Neni 111 ndryshohet si më poshtë:</p> <p>“Neni 111</p> <p><b>Zgjedhja në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj me propozim të institucioneve të tjera.</b></p> <p>1. Për kandidaturat në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, të cilat zgjidhen nga Kuvendi, me propozim të institucioneve të tjera, me përjashtim të rasteve kur nuk është parashikuar ndryshe në Kushtetutë ose në ligj, zhvillohet procedura e për zgjedhjes si më poshtë:</p> <p>a) Sekretari i Përgjithshëm tre muaj përpara përfundimit të mandatit ose menjëherë në rastet e shkarkimit të anëtarit të organit kushtetues ose të krijuar me ligj njofton me shkrim institucionin propozues, i cili fillon praktikatat për zgjedhjen e anëtarit të ri.</p> <p>b) Kandidaturat duhet të paraqiten në Kuvend 45 ditë përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të organit dhe jo më vonë se 10 ditë pas shkarkimit të tij.</p> <p>c) Me paraqitjen e kandidaturave, Kryetari i Kuvendit ia kalon ato menjëherë komisioni përgjegjës, i cili brenda tre javëve nga marrja e kërkesës organizon seanca dëgjimore publike me secilin kandidat dhe</p>	<p>Dakord.</p>	<p>-</p>

<p>vendos nëse kandidaturat i plotësojnë kriteret kushtetuese, ligjore dhe meritën.</p> <p>ç) Në rastin kur ka mangësi në dokumentacion për kandidaturën, komisioni i kërkon zyrtarisht institucionit propozues për plotësimin e tij. Në rastin kur kandidatura nuk plotëson kriteret ligjore të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, komisioni i kërkon Kryetarit të Kuvendit të njoftojë institucionin propozues. Procedura e shqyrtimit në Kuvend vazhdon me paraqitjen e kandidaturës së re nga institucioni propozues.</p> <p>2. Kuvendi shqyrton propozimin dhe kryen votimin për kandidatët në seancë plenare brenda një jave nga paraqitja e raportit të komisionit përkatës.</p> <p>3. Kur asnjë nga kandidatët nuk merr shumicën e kërkuar të votave, Kuvendi njofton institucionin propozues. Procedura fillon me kandidatura të tjera nga e para, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe.</p>		
<p><b>Neni 15</b></p> <p>Pas nenit 111, shtohet neni 111/1 me përmbajtje si më poshtë:</p> <p>“Neni 111/1</p> <p><b>Zgjedhja në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj me propozim të një grupi deputetësh.</b></p> <p>1. Për kandidaturat në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, të cilat zgjidhen nga Kuvendi, me propozim të një grupi deputetësh, me përjashtim të rasteve kur nuk është parashikuar ndryshe në</p>	<p>Dakord.</p>	

Kushtetutë ose në ligj, zhvillohet procedura e përzgjedhjes si më poshtë:

- a) Komisioni përgjegjës, tre muaj përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të organit kushtetues ose të krijuar me ligj vendos shpalljen dhe publikimin e vakancës në faqen zyrtare të Kuvendit. Afati për paraqitjen e kandidatëve është 20 ditë nga publikimi i vendimit.
  - b) Në përfundim të afatit të përcaktuar në shpallje, komisioni përgjegjës u bën të njohur anëtarëve të Kuvendit listën me kandidaturat e vetëofruara si dhe brenda 5 ditëve nga dërgimi i listës, organizon dëgjuesën e hapur publike në mjediset e Kuvendit, ku njoftohen të marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij. Lista me kandidatët e vetëofruar bëhet publike në faqen zyrtare të Kuvendit.
  - c) Brenda tre javëve nga dëgjesa publike, të paktën 28 deputetë përzgjedhin kandidatin, që do të mbështesin për t'ia propozuar Kuvendit, sipas cilësive profesionale dhe performancës gjatë prezantimit.
  - ç) Mbështetja me nënshkrimet e të paktën 28 deputetëve depozitohet zyrtarisht në protokollin e Kuvendit. Kryetari i Kuvendit ia kalon ato menjëherë komisionit përgjegjës, i cili brenda tre javëve nga marrja e kërkesës, vendos nëse kandidaturat i plotësojnë kriteret kushtetuese, ligjore dhe meritën.
2. Kuvendi shqyrton propozimin dhe kryen votimin për kandidatët në seancë plenare brenda një jave nga paraqitja e raportit të komisionit përkatës.
  3. Kur asnjë nga kandidatët nuk merr shumicën e kërkuar të votave, Kuvendi rishpall vakancën, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe.

<p><b>Neni 16</b></p> <p>Në nenin 115 pika 1, ndryshohet si më poshtë:</p> <p>“1. Kërkesa për shkarkimin e anëtarëve i paraqitet Kryetarit të Kuvendit me shkrim dhe në mënyrë të motivuar e konkrete për shkaqet e parashikuara në ligj, nga jo më pak se 28 deputetë, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe.”</p>	Dakord.	
--	---------	--

**ANEKSI NR. 2**

**KOMENTE DHE AMENDAMENTE MBI PROPOZIMET E KRYETARIT TË KUVENDIT  
PËR NDRYSHIMET NË RREGULLOREN E KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

PROPOZIMI	KOMENTE	RIFORMULIM PD
<p><b>Neni 1</b></p> <p>Në nenin 27/1, pika 3, fjalët “si rregull 7 ditë përpara” hiqen.</p>	<p>Dakord</p>	<p>-</p>
<p><b>Neni 2</b></p> <p>Neni 28 bëhen këto ndryshime:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Në pikën 2 fjalia e dytë hiqet.</li> <li>Në fund të pikës 5 shtohen fjalët “me përjashtim të projektligjeve që synojnë përafrimin e legjislacionit, marrëveshjet që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe/ose detyrimeve që dalin nga procesi i negociatave të anëtarësimit për respektimin e afateve që është i nevojshëm për respektimin e afateve që rrjedhin nga procesi i negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.”.</li> </ol>	<p>Dakord</p> <p>Mund të shtohet një paragraf në nenin 27 ku specifikohet përparësia në shqyrtimin e këtyre projektligjeve.</p>	<p><b>Në nenin 27 shtohet paragrafi 6, me përmbajtje si vijon:</b></p> <p>“6. Projektligjet që synojnë përafrimin e legjislacionit, marrëveshjet që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe/ose përmbushjen e detyrimeve që dalin nga procesi i negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, shqyrtohen me përparësi, kur është e nevojshme për respektimin e afateve që rrjedhin nga procesi i negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.”.</p>

### Neni 3

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Për të diskutuar ose vendosur në seancë plenare për çështje që nuk janë në rendin e ditës, Kuvendi merr vendim me jo më pak se shumicën e deputetëve të pranishëm. Propozimet për ndryshimin e rendit të ditës paraqiten me shkrim nga jo më pak se 10 deputetë, nga një kryetar i grupit parlamentar vetëm para fillimit të seancës, para fillimit të diskutimit të një pike të rendit të ditës ose kur është pezulluar diskutimi. Në rastet kur kërkesën nuk e bën grupi parlamentar, kërkesa paraqitet nga një deputet dhe grupi mbështetës prej 10 deputetësh ngrihen në këmbë.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Propozimet për ndryshimin e rendit të ditës kërkohen përpara fillimit të shqyrtimit të rendit të ditës, me kërkesë të kryetarit të komisionit ose kur kërkohet nga 1/4 e anëtarëve të komisionit. Vendimi për ndryshimin e rendit të ditës merret me më shumë se gjysmën e anëtarëve të komisionit.”.

Nuk jemi dakord me ndryshimin e shumicës së miratimit të ndryshimit të rendit të ditës. Rregulli i përgjithshëm që garanton transparencën dhe demokracinë parlamentare, është që rendi i ditës njoftohet jo më vonë se dy ditë para seancës, duke i dhënë mundësi deputetëve që të kenë në dispozicion një kohë të mjaftueshme për përgatitje. Përfundimi nga ky rregull, nuk është një ngjarje e zakonshme për Kuvendin, dhe kërkon mirëkuptim dhe konsensus. Kjo është arsyeja pse Rregullorja aktuale parashikon një shumicë të cilësuar për të përfshirë një çështje për diskutim në seancë, që nuk është njoftuar në kohë për deputetët.

I njëjti rregull vlen edhe për veprimtarinë në Komisionet Parlamentare.

Të mos përfshihet ky ndryshim

	<p>Ne nuk gjykojmë që duhet të ketë ndërhyrje në nenin 31 të Rregullores.</p>	
<p><b>Neni 4</b></p> <p>Në nenin 32 në fund të pikës 2 shtohet fjalia më këtë përmbajtje:</p> <p>“Kur mbledhja e komisionit thirret nga 1/4 e anëtarëve të tij, data dhe ora e mbledhjes së komisionit vendoset nga kryetari i komisionit brenda 5 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës.”.</p>	<p>Dakord në parim, por të riformulohet</p>	<p>Në nenin 32 në fund të pikës 2 shtohet fjalia më këtë përmbajtje:</p> <p>“Kur mbledhja e komisionit thirret nga 1/4 e anëtarëve të tij, data dhe ora e mbledhjes së komisionit vendoset nga kryetari i komisionit dhe mbledhja është e detyrueshme që të realizohet brenda 5 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës.”.</p>
<p><b>Neni 5</b></p> <p>Në nenin 34, pika 2, pas fjalëve “kalendarin dhe punimet e tij” shtohen fjalët “për bashkimin e nismave, të cilat i referohen të njëjtit ligj ose të njëjtit objekt.”</p>	<p>Dakord në parim, por të riformulohet</p>	<p>Në nenin 34, pika 2, pas fjalëve “kalendarin dhe punimet e tij” shtohen fjalët “për bashkimin e shqyrtimit të nismave, të cilat i referohen të njëjtit ligj ose të njëjtit objekt.”</p>
<p><b>Neni 6</b></p> <p>Në nenin 36 bëhen këto ndryshime:</p>	<p>1. Nuk jemi dakord me riformulimin e titullit. Seancat dëgjimore në Komision, nuk realizohen vetëm për funksionin ligjvënës të Kuvendit, por edhe për</p>	<p>Në fund të pikës 1 shtohet fjalia më këtë përmbajtje:</p> <p>“Kur seanca dëgjimore kërkohet nga 1/3 e anëtarëve të komisionit, data dhe ora e mbledhjes së komisionit vendoset nga kryetari</p>

<p>1. Titulli i nenit bëhet “Seanca dëgjimore publike në procesin legjislativ”.</p> <p>2. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia më këtë përmbajtje:</p> <p>“Kur seanca dëgjimore kërkohet nga 1/3 e anëtarëve të komisionit, data dhe ora e mbledhjes së komisionit vendoset nga kryetari i komisionit brenda 5 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës.”.</p>	<p>funksionet e tjera të tij, përfshirë atë të mbikëqyrjes parlamentare. Komisioni duhet të ruaj të drejtën kushtetuese të deputetëve për të thirrur në Komision për cdo çështje me interes publik, titullarët e institucioneve. Kjo buron drejtpërdrejt nga pika 3, e nenit 80 të Kushtetutës.</p> <p>2. Dakord në parim, por të riformulohet</p>	<p>i komisionit dhe mbledhja është e detyrueshme që të realizohet brenda 5 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës.”.</p>
<p><b>Neni 7</b></p> <p>Në nenin 38, pika 3, pas fjalëve “Diskutimi në parim bëhet gjithmonë në prani të” shtohen fjalët “nismëtarit, si dhe”.</p>	<p>Dakord</p>	<p>-</p>
<p><b>Neni 8</b></p> <p>Në nenin 39 bëhen këto ndryshime:</p> <p>1. Pika 1 ndryshon si më poshtë:</p> <p>“1. Mbledhjet e komisioneve regjistrohen dhe transkriptohen në mënyrë të plotë në procesverbalin e mbledhjes.”.</p>	<p>Dakord</p>	<p>-</p>

<p>2. Në pikën 2 fjalët “procesverbal i përmbledhur” zëvendësohen me fjalën “procesverbal”.</p> <p>3. Pika 3 hiqet.</p> <p>4. Kudo në tekstin e Rregullores fjalët “procesverbal i përmbledhur” zëvendësohen me fjalën “procesverbal”.</p>		
<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b></p> <p>Në nenin 52 fjalët “dhe vetëm një herë për të njëjtën çështje” hiqen.</p>	Dakord	-
<p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b></p> <p>Në nenin 58, pika 2, pas fjalëve “dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave” shtohen fjalët “shqyrtimi i projektligjeve”.</p>	Dakord	-
<p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b></p> <p>Në nenin 63, pika 1, shkronja “d”, në nenin 65, pika 2, në nenin 65/1 dhe në nenin 65/2 fjalët “10</p>	Dakord	-

<p>ditë, 30 ditë ose 60 ditë” zëvendësohen me fjalët “10, 30, ose 60 ditë kalendarike”.</p>		
<p><b>Neni 12</b></p> <p>Në nenin 65/2 pika 4 ndryshon si më poshtë:</p> <p>“4. Masat disiplinore “përfjashtim nga pjesëmarrja në seanca plenare/komisione” llogaritet me ditë kalendarike dhe shoqërohet me sanksion financiar të ndalimit të pagës së deputetit për aq ditë sa është marrë masa disiplinore.”.</p>	<p>Dakord</p>	
<p><b>Neni 13</b></p> <p>Në nenin 68 bëhen shtesa dhe ndryshime si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Në pikën 2 pas fjalës “relacion” shtohen fjalët “i cili nisur nga qëllimi, objektivat e hartimit të tij dhe <i>acquis</i>”.</li> <li>2. Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2 me këtë përmbajtje:</li> </ol> <p>“2/2. Projektligjet që synojnë përaftrimin e legjislacionit, marrëveshjet që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe/ose detyrimeve që dalin nga procesi i negociatave të anëtarësimit depozitohen në Kuvend të shoqëruara me kartelën përkatëse “BE”, e cila hartohet nga</p>	<p>Dakord</p>	

<p>propozuesi dhe përmban, në mënyrë të përmbledhur:</p> <p>a) referencat ndaj instrumenteve përkatëse të <i>acquis</i> të Bashkimit Evropian;</p> <p>b) natyrën dhe shkallën e përafritimit (transpozim, amendim ose zbatim);</p> <p>c) lidhjen e projektligjit me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe/ose procesi i negociatave për anëtarësim;</p> <p>ç) çdo element tjetër të nevojshëm për identifikimin e ndikimit të projektligjit në legjislationin e përafuar me <i>acquis</i> të Bashkimit Evropian.”</p>		
<p><b>Neni 14</b></p> <p>Në nenin 83 bëhen këto ndryshime:</p> <p>1. Titulli i nenit 83 bëhet: “Shqyrtimi nen nën i buxhetit në komisione.”</p> <p>2. Pika 1 ndryshon si më poshtë:</p> <p>“1. Me miratimin në parim të projektligjit për buxhetin e shtetit dhe projektligjeve financiare në seancë plenare, komisionet e përhershme të Kuvendit fillojnë shqyrtimin nen nën të projektligjit për buxhetin. Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat në cilësinë e komisionit përgjegjës, fillon shqyrtimin nen nën duke shqyrtuar edhe rekomandimet apo amendamentet në raportet e komisioneve për</p>	<p>Dakord</p>	

<p>dhënie mendimi, si dhe të Sekretariatit për Buxhetin e Kuvendit ose nga Kuvendi në seancë plenare.”.</p>		
<p><b>Neni 15</b></p> <p>Në nenin 86, pika 6, në fund të fjalisë shtohen fjalët “edhe në ato raste kur jo të gjitha vlerësohen nga Kuvendi si arsye të vlefshme për kthim.”.</p>	Dakord	-
<p><b>Neni 16</b></p> <p>Në nenin 87 bëhen ndryshime:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Në pikën 1 pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje: <ul style="list-style-type: none"> <li>“dh) vendime të tjera të Gjykatës Kushtetuese sipas nenet 132 të Kushtetutës, zbatimi i të cilave është përcaktuar si detyrim i Kuvendit të Shqipërisë.”.</li> </ul> </li> <li>Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje: <ul style="list-style-type: none"> <li>“6. Në rastet kur Këshilli i dërgon/paraqet nismëtarit rekomandimet për ndërmarrjen e nismës, ky i fundit detyrohet të raportojë për zbatimin e tyre në komisionin përgjegjës që ka miratuar aktin brenda afateve të përcaktuara nga Gjykata Kushtetuese në vendim ose brenda 6 muajve nga dërgimi i këtij rekomandimi.”.</li> </ul> </li> </ol>	Dakord	-

<p><b>Neni 17</b></p> <p>Në fund të nenit 88 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:</p> <p>“Procedura e votimit për aktet sipas paragrafit të parë të këtij neni bëhet vetëm 1 herë për miratimin apo mosmiratimin e tyre.”.</p>	<p>Ky ndryshim është i vlefshëm vetëm për Aktet Normative me fuqinë e ligjit të nxjerra nga Këshilli i Ministrave. Por një rregull i tillë nuk është i zbatueshëm për projektvendimet normative që miratohen nga Kuvendi. Ato duhet të jenë objekt miratimi në parim, nën për nen dhe në tërësi, dhe mbi to deputetët mund të paraqesin amendamente.</p> <p>Për këtë arsye, sugjerohet që të riformulohet propozimi.</p>	<p>Në fund të nenit 88 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:</p> <p>“Në rastin e akteve normative me fuqinë e ligjit të nxjerra nga Këshilli i Ministrave, procedura e votimit është vetëm 1 votim për miratimin apo mosmiratimin e tyre.”.</p>
<p><b>Neni 18</b></p> <p>Në neni 96, pika 3, në fjalinë e dytë fjalët “si rregull” hiqen.</p>	<p>Mendojmë që kjo fjali duhet të riformulohet tërësisht, për shkak se aty parashikohet zhvillimi i interpretancës në seancën plenare të së hënës, ndërkohë që Kuvendi prej kohësh nuk zhvillon seancë plenare ditën e hënë, vecse një herë në muaj në përfundim të javës së dedikuar për zgjedhësit.</p>	<p>Në neni 96, pika 3, në fjalia e dytë riformulohet si më poshtë:</p> <p>“Ato përfshihen në rend dite në një nga tre seancat pasardhëse nga data e paraqitjes, përveçse kur është kërkuar sipas rregullave të nenit 97 të kësaj Rregulloreje”.</p>